

VENDIM
Nr. 251, datë 16.8.2023

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “JOINT VENTURE 2B 1979 DHE 2T” SHPK
PËR LICENCIM, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR
2 mw**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 16.8.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1964/8 prot., datë 14.8.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Joint Venture 2B 1979 dhe 2T’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1964 prot., datë 25.7.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në zonën Grykë, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 241, datë 3.8.2023, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për arsye se në këtë aplikim nuk ishte depozituar asnjë dokument, ku Bashkimi i Përkohshëm i shoqërive “2T” sh.p.k. dhe “2B 1979” sh.p.k., i cili mban dhe miratimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për ndërtimin e centralit fotovoltaik, me nr. 7234/2 prot., datë 22.11.2022, t’i ketë njohur të drejtën shoqërisë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. për të operuar këtë central.

- ERE, me shkresën nr. 1964/6 prot., datë 8.8.2023, njoftoi shoqërinë për këtë vendim dhe i bëri me dije nevojën e plotësimit të dokumentacionit të konstatuar të munguar, si dhe se në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pika 7, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen, dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nëse shoqëria, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e vendimit për mos fillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

- Shoqëria “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1964/7 prot., datë 10.8.2023, brenda afatit të sipërcituar, ka përcjellë në ERE deklaratën noteriale nr. 3723 rep., nr. 1949 kol., datë 10.8.2023, nëpërmjet së cilës përkatësisht shoqëria “2T” sh.p.k., shoqëria “2B 1979” sh.p.k. dhe shoqëria “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., deklarojnë se, sipas miratimit për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike, fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 mw, dhe veprave ndihmëse, në zonën Grykë, Bashkia Fier, qarku Fier”, nr. 7234/2, datë 22.11.2022, shoqëria “Joint Venture 2B 1979 dhe 2 T” sh.p.k. do të kryejë operimin e impiantit gjatë të gjithë periudhës së afatit të licencës.

- Për sa më sipër dhe në referencë të përcaktimeve në faqet 1 dhe 2 të kontratës së nënshkruar me MIE-n (nr. 340 rep., nr. 1429 kol., datë 19.5.2023), ku është parashikuar e drejta për krijimin e një shoqërie për qëllime të veçanta, aplikuesi duhet të bëjë me dije në ERE, nëse ka njoftuar MIE-n mbi krijimin e kësaj shoqërie të re nga Bashkimi i Përkohshëm i Shoqërive “2T” sh.p.k. dhe “2B 1979” sh.p.k.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a”, dhe “c”; për pikën 2.1, germat “a”, “b”, “d” dhe “f”.

- Nga ky aplikim rezulton, gjithashtu, se nevojitet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Pika 2, “Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës”

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”

- Germa “b”: Të depozitohet në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshminë e penaltetit) për vetë shoqërinë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- Germa “b”: Të depozitohet në ERE vendimin e organeve drejtuese të shoqërisë “2T” sh.p.k. ku të miratohet financimi dhe vënia në dispozicion e vlerës financiare të nevojshme për ndërtimin e centralit fotovoltai.

- Duke qenë se miratimi për pikën e lidhjes dhe VNM-së paraprake janë dhënë për kapacitetin 1950 kw, ndërkohë që në kontratën me MIE-n nr. 3110 rep., nr. 1429 kol., datë 19.5.2023, është parashikuar që kapaciteti i centralit është 2 mw, aplikuesi duhet të depozitohet sqarimet përkatëse se përse në miratimin për pikën e lidhjes me rrjetin e transmetimit dhe VNM-së paraprake kapaciteti nuk është i njëjtë me atë të përcaktuar në kontratën me MIE-n.

- Po ashtu, duke qenë se shoqëria ka parashikuar të ndërtojë veprën brenda vitit 2023, por dhe në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së paraprake, vlerësohet t’i kërkohej informacion nëse ka filluar me punimet e saj.

- Në lidhje me sa deklaruar për jetëgjatësinë e pritshme të centralit prej 30 vjetësh, duke qenë se nga rastet analoge të mëparshme ka rezultuar se një central fotovoltai e ka jetëgjatësinë 25 vjet, do t’i kërkohej aplikuesit të depozitohet në ERE dokumentacion teknik mbështetës për sa deklarohej nga ana e tij, për arsye se nga kjo jetëgjatësi do të varet dhe vlefshmëria e licencës për prodhimin e energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Joint Venture 2B 1979 dhe 2T” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

